



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosova
Federacija Sindikata Zdravstva Kosova




Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Koalicioni PDK-AAK-NISMA, më datë 01.06.2017, dakordohen me këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI


1. FSSHK dhe Koalicioni PDK-AAK-NISMA pas diskutimit të kërkesave të adresuara nga FSSHK, dakordohen përmes kësaj marrëveshjeje që bashkërisht të punojnë në përmirësimin e gjendjes në sistemin shëndetësor;
2. Palët zotohen për një bashkëpunim të mirëfilltë në të mirë të shëndetësisë dhe punëtorëve shëndetësor;
3. Me këtë marrëveshje kërkohet :
 - 3.1. Shëndetësia të jetë prioritet
 - 3.2. Rritja e buxhetit për shëndetësi
 - 3.3. Rritja e pagave(pasi qe tri vite nuk ka pasur rritje)
 - 3.4. Në 3 muajt e parë të qeverisjes eventuale:
 - a) Të fillohet me pagesën e rrezikshmërisë në vendin e punës për të gjithë punëtorët shëndetësor;
 - b) Të përmirësohet dukshëm furnizimi me material shpenzues dhe barna me qëllim që të na mundësohet ofrimi cilësor i shërbimeve shëndetësore
 - c) Ligji mbi pagat të hartohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e punëtorëve shëndetësorë-FSSHK ,ku punëtorët shëndetësor do të kenë vendin e merituar;
 - 3.5. Inicimi i plotësim ndryshimeve të legjislacionit në sektorin e shëndetësisë, me qëllim të inkorporimit të mjekësisë primare në zinxhirin e sistemit publik shëndetësor
 - 3.6. Po ashtu të punohet në decentralizimin e sistemit shëndetësor me qëllim të menaxhimit më të përgjegjshëm të institucioneve shëndetësore
 - 3.7. Bashkërisht të punohet në ruajtjen e mantel bardhëve nga linçimet publike.

4. Palët pajtohen që menaxheret në shëndetësi duke filluar nga niveli më i lartë të bëhen në koordinim të përbashkët në mënyrë që të vendoset dialogu i mirëfilltë social.


Ramush Haradinaj (AAK)

Handwritten signature of Ramush Haradinaj in black ink, written over a horizontal line.

Kadri Veseli (PDK)

Handwritten signature of Kadri Veseli in black ink, written over a horizontal line.

Blerim Syla (FSSHK)

Handwritten signature of Blerim Syla in black ink, written over a horizontal line.